



SHTATOR 1999

# PERIODIKU KLV

Publikim i Komisionit te Letrave me Vlere

Numri I

## MIRESE VINI NE "PERIODIKU KLV"

Miresevini ne bohimin e pare te "Periodiku KLV", publikimi i ri periodik i Komisionit te Letrave me Vlere. Me kete "Periodiku KLV" na synojme te krijojme nje tradite te re te dhenies se nje informacioni te sakte, interesant, te shpejte dhe te doishem mbi zhvillimin e tregut te kapitaleve, si dhe mbi veprimtarine e Komisionit.

Qellimi kryesor i "Periodiku KLV" eshte tu vije ne ndihme te gjithe atyre qe zhvillojnë aktivitet ne Tregun Shqiptar te Kapitaleve, si dhe te ndikoje ne permiresimin e vazhdueshmen te ketij aktiviteti. Faqet e "Periodiku KLV" do te jene te hapura jo vetem per profesionistet por edhe per prakticianet qe i japin jete tregut me veprimtarine e tyre te perdithshme.

Nje nga qellimet e tjera te "Periodiku KLV" eshte te raportoje dhe te jape shpjegime ne meryre te vazhdueshme mbi veprimet e rinderraria, apo qe planifikohen te ndërmen nga Komisioni te bese komerciale mbi ate qe mësodh na tregun financier, si dhe te mundesoje kembimin e opiononeve dhe eksperiencave.

"Periodiku KLV" synon te jetë nje alternative tjeter komunitare midis Komisionat dhe pjesmarresve ne tregun e kapitaleve, per nje zhvillim te mëtejshem te ketij tregu dhe arriten e standardeve nderkombetare ne marrdheriet e biznesit, me qellim forcimin e marrdherieve te tregut shqiptar te kapitaleve me komunitetin financiar nderkombetar.

"Periodiku KLV" do te botohet ne shqip dhe anglisht. Periodiciteti i botimit do te varet nga zhvillimi i tregut shqiptar te kapitaleve si dhe nga nevojat e perdonuesve.

## Projekt-Ligji mbi "Investimet Kolektive ne Fondet e Letrave me Vlere"

Ky ligji do te kete si objektiv mbrojtjen e investitorave duke ndaluar promovimin e fondave kolektive para se ato te licensohen nga KLV, dhe duke regulluar veprimtarinë e ketyre fondave te licensuara. Projekti përmakten kryimin e fondave në dy forma: fonde te krijuara mbi baze kontrakt, te quajtura fonde investimi, dhe fonde te krijuara si shoqeri tregtar te quajtura shoqeri investitor. Gjithashu projekti përkaktan edhe kërkesat e nevojshme per licensum. Projekt-Ligji përbën nje strukturë te qendrueshme dhe te plotë per regulimin e veprimtarise se fondave kolektive, ku delaje regulatore do te mbulohen nga regulla qe do te miratohen nga Komisioni dhe Këshilli i Ministrave. Jane bere te gjitha perpektjet qe ky ligji te jetë ne përpjthje me Eurektivat e Komunitetit European dhe Panimet e Pergjithshme te IOSCO-s. Komisioni ia paraqiti projekt-ligjin, per diskutim dhe per te marrë opinionen, institucionave te udhëshme Gjithashu, u ngri edhe nje Komitet per te perfunduar procesin e projektimit. Aktualisht projekt-ligji i ka kaluar Qeverense, e cila do t'a paraqesë se shpejti Parlamentit.

Komisioni i Letrave me Vlere eshte autoriteti kryesor dhe i vetem regulator i Tregut te Kapitaleve ne Shqiperi, me vendndodhje ne Tirane. Ai është krijuar dhe vepron ne mbështetje te Ligjit Nr. 8080, date 1.3.1996 "Per letrat me vlere".

Komisioni i Letrave me Vlere permbahet nga shtate komisionere, te cilat emerohen me propozim te Presidentit te Republikes, dhe me miratim te Kuvendi Popullor. Komisioni mbidhet ne takime te regjulta, ku merrin vendime, caktohen prioritete, diskutohet per programet ne vazhdim dhe te perspektivës dhe i caktohen detyra per zbatim personell te punuesuar.

Misioni i Komisionit te Letrave me Vlere eshte:

- Te siguroje standarta te larta per mbrojtjen e investitoreve;
- Te nxise besueshmerinë ne eficencën e tregut te letrave me vlere ne Shqipëri, ne mënyrë qe te mbështesë zhvillimin e tij te vazhdueshëm;
- Te gjejë ekilibrin e përshtatshem midis masave, qe sigurojnë mbrojtjen e investitoreve dhe masave, qe inkurajojn zhvillimin dhe modernizimin e tregut;
- Te mbikoye efektivitetin e tregjeve te letrave me vlere, institucionet qe kryejnë pastrimin dhe regulumin e ligarive dhe aktivitetin e pjesmarresve te tregut;
- Te veproje drejt dhe me vendosmeri duke u ëne e adaptueshme, e perqejgishme dhe e hapur per pjesmarresit e tregut dhe publikun investues;
- Te kryejë te gjitha funksionet dhe detyrat e tjera te parashikuara ne Ligji.

### Ju lutemi te na kontaktoni:

Komisioni i Letrave me Vlere  
Prane Min. se Drejtësise, kat. III  
Kutia Postare 4863, Tirana, ALBANIA  
tel/fax: ++355 42 28260  
web site: <http://www.asc.gov.al>  
email: [asc@albaniaonline.net](mailto:asc@albaniaonline.net)



## PROPOZIM PER NJE BURSE TE RE NE SHQIPERI (permblehdje)

Propozimi u pergati pas konferencës "Alternativa per Tregun e Kapitaleve ne Shqiperi" dhe aktualisht Komisioni eshte duke mbledhur opionime lidhur me kete propozim.

### Veshtrim

Situata aktuale (fillimi i 1999) te le te kuptosh se, po qe se nuk ndermerr edhe ndonje veprim, shume shpejt nuk do te kete ndonje organizate qe do krye funksionet e burses, por edhe ne qofte se do te kete, praktikisht nuk do te kemi letra me vlore te cilat ajo do te mund ti tregtoje. Organizata ekzistuese, Bursa e Tiranes eshte rreth departament i Bankes se Shqiperise te cilin Banka deshronon "shkepusë". Aktiviteti i tregimit te bonove te thesanit i cili ka qene funksioni i vetem komersial i Burses se Tiranes do vazhdoje te zhvillohet brenda Bankes.

Megjithatë, ka rreth deshure te pergjithshme qe duhet te ekzistoje një treg formal i letrave me vlore ne Shqiperi dhe kjo u evidentua ne konkluzionet e Workshop-it per Tregun e Letrave me Vlere te organizuar nga Komisioni i Letrave me Vlere & Financial Services Volunteer Corps, dhe te mbajtur ne Struga ne Mars 1999. Konkluzionet kryesore ishin:

- Ekonomia shqiptare ka nevoje per një treg kapitalesh
- Qeveria duhet te aprovoje dhe te krijoje lehtesira per zhvillimin e tregut te kapitaleve, dhe
- Zhvillimi i tregut te kapitaleve varet gjere respektive politika dhe taktikave privatizimit

Per sa i perket ceshijes se Burses, ekziston nevoja per knjimin e rreth subjekti te ri juridik ne te cilin mund te transferohen aktiviteti, stafi dhe asetat ekzistuese te Burses se Tiranes. Pjesmarrësit ne Workshop pranuan unarimisht se Bursa e re duhet te jete rreth shoqerit akacionere dhe pati disa shenja se ndoshta mund te jete e financuar privatish.

### Strategji per startimin e rreth Burse te re

Duke reaguar ndaj konkluzioneve te Workshop-it, ky Propozim mban rreth strategji te vecante per zhvillimin e Burses. Natyrish nuk eshte strategji e vetme e mundshme, ka shume te tjera, por kjo strategji bazohet ne kater objektiva kryce:-

- Bursa te jete e financuar dhe e drejtuar privatish
- Bursa te terheqe maksimumin e asistencave teknike dhe financiare nga donatorët e huaj
- Bursa te jete rreth institucion kombetar i besueshem
- Bursa te kete rreth sens te zhvilluar finanziar si rreth subjekti i pavarruar

### Propozimi i zbatimit

#### Takimi ne vijim

Funksioni esencial i takimit ne vijim eshte te aprovoje Propozimin - ose ne formen e tij fillestare, ose me ndryshime e modifikime. Aprovimi varet nga fakti nese Qeveria vendos te ndjekje rreth politike per te mbeshtetur Buren e re permes implementimit te programit te privatizimit. Por gjithashtu, duhet qe kjo te jete

e injafueshme per te bindur ofruesit private te financimeve se ia viente vesh parate ne Buren e re. Duke supozuar qe bihet dakort per keto ceshije, faza tjeter do te jetë ngritura e një komite pune nga themeluesit potenciale te Burses per te bere perqatjet e nevojshme per formimin e institucionit te tij.

#### Takimi i formimit

Formalitetet per krijimin e shoqerise do te ishin mbajtja e takimit te formimit nga anetaret themelues, aprovimi i statutit dhe emerimi i bordit, te ndjekura nga regjistrimi i shoqerise se re ne gjykate.

Thelbi i procesit te formimit ka te beje me rregullimet e nevojshme ne lidhje me financeren dhe konstituimin e organizates se re, duke mos harruar ndërkohe dhe kërkesat rregullatore te Komisionit te Letrave me Vlere. Te gjitha keto duhet te jene sinqerat, duhet te jetë arritur konsemni ne komitetin e punes dhe me palel e tjera te perfshira, perpara takimit te formimit.

#### Rekrutimi, trajimi dhe procedurat e tjera

Pasi te jetë bere krijimi i Burses se re si personi juridik, ajo mund te lidhe kontrata dhe marreveshje me pale te treta per sigurimin e burimeve te nevojshme ne menyre qe te filloje te marre persipër perqiegjeje e saj. Poq eshte e rendesishme qe shume gjera duhet te jene planifikuar ne avance. Ne vecanti, donatoret duhet te jene mbajtur ne dijeni te projektit qe nga fillimi dhe, ne qofte se eshte e mundur, ata duhet te kene rene dakort midis tyre se si te shpendajne financimin ne qofte se do kete me shume se rreth donator.

Eshe e natyrshme qe pasi te jetë krijuar Bursa e re, ajo do te emerohet rreth Drejtore qe do te veproje si drejtues projekti per kete fazë te zhvillimit. Ai apo ajo ndoshja edhe mund te asistohet nga rreth eksperti huaj.

Asistenca teknike dhe trajimi per Buren e re mund te perfshi me mbulimin e:-

- Aktivitetet e rregulluese te Bordit (berjen e rregullave, ndjekja e zbatimit te tyre, apelimet, etc.)
- Listimit dhe informimit te vazhdueshem
- Anastesise, mbikqyrtje
- Sistemeve dhe mbikqyrtje se tregtimit
- Pastimit dhe rregullimit te llogarive dhe transaksioneve
- Trajimit te Brokerave
- Ndergjegjesimit te publikut
- Ndergjegjesimit te emetuesve

#### Licensimi

Fakti qe Buren e re do t'ju duhet te licensohet nga Komisioni eshte rreth supozim. Nje supozim tjeter alternativ eshte qe Bursa ekzistuese e Tiranes, e cila eshte autonzoar nga Banka e Shqiperise sipas Kapitullit 3 te Ligjit "Per Letrat me Vlere", duhet ne rreth fare menyre te perjashtohet nga rilicensimi prej Komisionit sipas Kapitullit 4 te ligjit ne qofte se asetat dhe personeli transferohen tek shoqeria e re. Natyrish i takon Komisionit te vendose.

Aprovimi nga Komisioni do te shenoje, per qellime administrative "fundin e projektit".





## MARREDHENIET NDERKOMBETARE

Ne 12 Shkurt 1999 u vendos nje program bashkepunimi midis CONSOB (Komisioni Kombetar per Shoqerite dhe Bursen, Itali) dhe KLV-se. Ky program bashkepunimi konsiston ne asistencen teknike qe CONSOB-i mund t'i ofroje KLV-se si dhe ne mundesine e shkembimit te informacionit per te mbeshtetur dhe lehtesuar efikasitetin e aktivitetit te tyre reguluator qe do te behet efektiv pas neshkrimit te Memorandumit te Mirekuptimit.

Ne 1 Prill 1999, Komisioni i Letrave me Vlere dhe Autoriteti i Tregut te Kapitaleve te Greqise neshkruan nje Memorandum Mirekuptimi per shkembimin e informacionit midis tyre. Ne kete kuader u vendos nje program bashkepunimi i bazuar ne asistencen teknike qe CMA (Autoriteti i Tregut te Kapitaleve, Greqi) ne bashkepunim me Bursen e Athines dhe Tregun Derivativ te Athines mund t'i ofrojne KLV-se.

Nga 22 deri 29 Maj 1999, një delegacion nga Komisioni i Letrave me Vlere morri pjesë ne evenimentin me te rendesishem te IOSCO (Organizata Nderkombetare e Komisioneve te Letrave me Vlere, Konferanca e XXIV-te Vjetore

## SUBJEKTET E LICENSUARA NGA KLV

Komisioni i Letrave me Vlere ka licesuar si tregtare te Bonove te Thesant subjektet e me poshtme:

- INSIG sh.a.
- BANKA NDERKOMBETARE TREGTARE
- BANKA ITALO-SHOQIPTARE
- MD & K sh.a.
- BANKA KOMBETARE GREKE
- BANKA KOMBETARE TREGTARE
- S.A.D. CAPITAL sh.a.
- BANKA E TIRANES

Se fundi Komisioni u ka dhene lice ne tregtarit te letrave me vlere S.A.D. CAPITAL sh.a. dhe MD & K sh.a. te cilat kane si aktivitet te vetem tregtimin e letrave me vlere. Komisioni ka filluar administrimin e testave profesionale per licensen e perfaqesuesit te tregtari qe perbejne nje nga kerkesat per manjen e kesa license.

zvilluar ne Lisbon, Portugali. Kjo konference me teme "Shekull i Ri, Siida te Reja per Tregjet Financiare" erdhë ne nje kohe ndryshimesh te shpejtja ne tregjet e kapitaleve. Kete vit Konferencia u perpendrua ne perpjekjet e vazhdueshme te bera nga IOSCO per te nxjix stabilitebin financiar dhe per te forcuar kuadrin regulator nderkombetar Zbatimi i Objektivave dhe Parimeve te procesit regulator te Letrave me Vlere nga ana e IOSCO-s, perpjekjet e saj per te permiresuar bashkepunimin nderkombetar pjese marja aktive ne diskutime nderkombetare te rendesishme, per çeshtje te cilat ndikojne ne letrat me vlere dhe tregjet e ardhshme, te gjitha keto perbejne nje kontribut te madh per forcimin e procesit regulator ne mbare boten. KLV ka punuar me kujdes per t'ia pershtatur bazen e vet regulatore Objetktivave dhe Parimeve te IOSCO-s mbi Rregullimin e Letrave me Vlere si dhe direktivave te Komunitetit European.

Ne 10 - 11 Korrik 1999, Komisioni i Letrave me Vlere morri pjesë ne Takimin e Pare te Rregullatoreve te Tregjeve te Kapitalit te Evropes Jug-Lindore, i cili i zhvillua ne Sofje, Bulgari. Pjesemarrja ne

kete takim u konsiderua e nje rendesie te veçante, sepse ai do te krijonte, per çdo vend, mundesine e vendosjes se marredhenieve te ngushta bilaterale dhe multilaterale ne kuadrin e proceseve integruese qe po ndodhin ne mbare boten, ne mbeshtete te parimeve te IOSCO-s, direktivave te EU dhe interesave te çdojnerit prej vendeve te rajonit. Ne kete takim u diskutua mbi Bashkepunimin Rajonal dhe zhvillimin e Tregjeve te Kapitaleve, mbi Bashkepunimin Nderkombetar dhe Integrimin Rajonal, mbi Prioritetet dhe Fushat e Bashkepunimit midis Rregullatoreve te Tregjeve te Kapitaleve te shteteve te Evropes Jug-Lindore, mbi Shkembimin e Informacionit (ad hoc, ligjore) dhe Mekanizmat e Ndaries se Informacionit, mbi Njohjen Reciproke te pjesmarreseve te licensuar te tregjeve, mbi Nevojat, Mundesite, Problemet. Gjithashtu, ne takim u vendos per nje bashkepunim ma te ngushte medis vendeve te rajonit, krijimin e nje qendre te shkembimit te informacionit dhe krijimin e grupave te punes per trajtimin e problemeve te tillave, njohja reciproke e tregtareve te licensuar, pershtaja e legjislacionit ne kuadrin e IOSCO-s etj.

## LISTA E AKTEVE LIGJORE TE ADMINISTRUARA NGA KLV

- Ligji Nr. 3020, "Mbi Letrat me Vlere", dt. 01.03.1996
- Rregullore Nr. 1 "Mbi Licensimin, Kuotat dhe Komisionin", dt. 28.03.1997
- Rregullore Nr. 2 "Mbi Burimet per Kerkesat Financiare dhe Kontabel", dt. 02.05.1997
- Rregullore Nr. 3 "Mbi publikimet ne Veprimtarine e Investimit ne Letrat me Vlere", dt. 12.05.1997 \*
- Rregullore Nr. 4 "Mbi Funkcionimin e Komisionit te Letrave me Vlere", dt. 01.08.1997
- Rregullore Nr. 5 "Mbi Funkcionimin e Administrates se Komisionit te Letrave me Vlere", dt. 01.08.1997
- Rregullore Nr. 6 "Mbi kerkesat Financiare dhe Kontabel te te Licensuarve", dt. 19.08.1997\*
- Rregullore Nr. 7 "Mbi Etiken ne Veprimtarine e Investimit ne Letrat me Vlere", 19.08.1997
- Rregullore Nr. 8 "Mbi Detyrimet per pergatitjen e Prospektit", 19.12.1997
- Rregullore Nr. 9 "Mbi Detyrimin e Emertuesve per Informim te vazhdueshem" dt. 13.01.1998 \*
- Rregullore Nr. 10 "Mbi Manjen e Paketes Kontrolluese te Aksioneve", dt. 21.12.1998
- Rregullore Nr. 11 "Mbi Strukturen Organizative dhe Detyrat e Administrates se KLV-se" dt. 29.06.1999

\* Rregulloret janë hartuar nga Komisioni qe pritet te miratohet nga Keshilli i Ministrave. Data e referencës se perfundimit te procesit te hartimit te Rregulloreve nga Komisioni Aktualisht, asaj prej ketyre Rregulloreve nuk eshte miratuar nga Keshilli i Ministrave.



## ARGUMENTA TE ORIKE MBI RREGULLIMIN FINANCIAR

### Motivet per vendosjen e nje Regjimi Rregulator

Motivi ekonomik per vendosjen e nje regjimi rregulator eshte shmanga e deshitimit te tregut. Ne rastin e tregjeve financiare mund te pemendim tre ceshjet: asimetria e informacionit, besimi ne tregjet financiare si nje e mire publike dhe risku i sistemit.

#### Asimetria e informacionit

Tregjet financiare karakterizohen nga nje asimetri thelbese e informacionit midis bleresit dhe skitesit. Bleresi eshte i paafte te vleresoje me sakteci cilësimet e produktit apo sherbimit qe merr ne momentin e transaktionit. Duhet te kaloje shume koha pas kryerjes se transaktionit qe te mund te zbulohet dobia e marrë nga produkti apo sherbimi.

#### Besimi si nje e mire publike

Eshe te qarte qe investitorët potenciale, nuk do ti investojnë parate e tyre ne produkte financiare nese ata janë te bindur qe tregu ka mashtrime, manipulime e te tjera si keto. Per te terhequr investime, tregjet financiare duhet te duken se punojne ne menyre te drejtë dhe te rregullt. Keshu, besimi ne mekanizmin e tregut dhe pjesem arrestit e tij eshte i nje rendesie te veçante. Nga ky kendeveshtim ai mund te analizohet si nje e mire publike. Ekonomistët i kanë veshur nje e mire te tille dy cilesi: konsumimi i se mires nga nje individ nuk zvogelon konsumimin e saj nga nje individ tjeter; dhe, nese tregu e ofron kete te mire per nje individ ai e ofron ate per te gjithe pjesem arrestit e tregut. Si rrejdhim, eshte e veshire qe te percaktohet çmimi i blerjes se nje te mire publike. Pra, tregu eshte i paafte te vetorganizohet per te prodhuar nje te mire te tille ne menyre spontane. Prandaj nje regjim rregulator eshte i nevojshem per te ndihmuar tregun ne sigurimin e nje te mire te tille. Ne rastin e tregjeve financiare kjo eshte shume e rendesishme sepse produktet financiare, per vete veçantin e tyre, janë "veçanerisht terheqese per kriminale te sofistikuar".

#### Risku i Sistemi

Nje tjeter element per tu patur parasysh eshte fakti se deshtimi i rje institucioni te madh, ofrues i sherbimeve financiare, çon ne nje kolaps te pergithshem financiar. Deshumi i nje banke te madhe ose nje remie ne Burse mund te shkaktojne nje panik tek investitorët dhe si rrejdhim nje kolaps te sistemit financiar. Ky ndryshon nga deshtimi i nje firme industriale. Ne rastin e firmave industriale, edhe pse ekonomia mund te dentohej rende nga nje kolaps i tyre, nuk do te krijohej nje panik per ndorje reaktione te ngjashem zinxhir. Keshu ekzistencë e riskut te sistemit ben te nevojshme vendosjen e rregullave te cilat synojne te garantojnë aftesine paguese te bankave dhe shtepive te brokenimit, dhe te pengojne qe biznesi financiar te kaloje nje limit te arsyeshem te aktivitetit.

### Zgjedhja e regjimit rregulator

Procesi rregulator do te shonte me i preferuar se "lassez faire" sa here qe kostoja e tij eshte me e vogel se kostoja e transaktionit qe lidhet me te plus koston e deshtimit te tregut. Per sa i perket reduktimit te deshtimeve te tregut, duhet marre ne konsiderate edhe efekti i progresit teknologik. Ai zakonisht e ben me te lehte hyrjen ne treg, keshu qe ndikimi i firmave mbi çmimin dhe inovacionet zvoglohen. Ne rrethana te tilla nje regjim rregulator nuk do te ishte me alternativa me e mire. Nje alternative me pak e kushtueshme do te ishte te lihet tregu te vepronente lini, sesa te synohej optimizimi nepermjet nje regjimi rregulator.

#### Ekuilibret qe duhet te ruaje regjimi rregulator

Regjimi rregulator financiar duhet te ruaje kater ekuilibre kryesore

#### Ekuilibri midis interesave ekonomike dhe atyre financiare

Regjimi rregulator duhet te ruaje nje ekuilibri midis interesave ekonomike dhe atyre financiare. Nga njera ana, aktiviteti financiar duhet te korrespondoje me nevojat ekonomike. Nje aktivitet financiar i papershtatshem eshte i dem shem per ekonomine. Nga ana tjeter, nuk mund te kete nje aktivitet te mire financiar pa nje ekonomi te shendoshe. Nje "fluske" financiare mund te vlerosohet si nje deshtim i regjimit rregulator.

#### Ekuilibri midis minorances dhe mazhorances se aksionereve

Regjimi rregulator duhet te ruaje ekuilibrin midis interesave te aksionereve ne minorance dhe aksionereve ne mazhorance te nje shoqerie aksionere. Marrja e paketes kontrolluese dhe bashkimet e shoquerive janë mjetë themelore per progresin ekonomik dhe industrial, megjithatë rregulatoret financiare duhet te punojne per te garantuar mosinjorimin e interesave te aksionereve ne minorance.

#### Ekuilibri midis aktivitetit financiar kombetar dhe nderkombetar

Duhet te kete nje ekuilibri midis aktivitetit financiar nderkombetar dhe interesave kombetare. Detyra e rregulatoreve eshte te evitojnë deshiimet e regjimit rregulator duke marrë gjithashut parasysh pasojat potenciale te aktivitetit nderkuftar dhe bashkëpunimit te gjere.

#### Ekuilibri midis procesit rregulator dhe lirise se biznesit

Procesi rregulator duhet te siguroje nje ekuilibri te arsyeshem midis rregullave te nevojshme dhe lirise se biznesit. Rol i rregulatorit eshte te zvillojte regime rregulatore qe do te ndikojne pozitivisht ne aktivitetin e biznesit. Ne kete kontekst objektivat kryesore te rregulatoreve janë integriteti i tregut, transparensa dhe mbrojtja e investitorëve.